



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/84

Datë: 19.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/84
Datë: 19.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për procedurat e aplikimit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/84
Datë: 19.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, duke marrë parasysh Vendimin e Kryeministrit Nr. 115/12, të datës 14 Maj 2012, për themelimin e Bordit për Politika Gjuhësore, si dhe në bazë të Rregullores Nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Znj. Suzana Salaji, emërohet Komisionere e Gjuhëve.
2. E emëruara nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha punët dhe detyrat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Mandati i të emëruarës nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 6 (gjashtë) vite.
4. Obligohen institucionet relevante të Kosovës që t'i japin mbështetjen e nevojshme Komisionerit për Gjuhët, në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve dhe Rregulloren nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/84

Datë: 19.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2012, mori:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohen shpronësimet për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdarë, segmentet 1, 2, 3, 4 dhe 5 (zonat kadastrale Vërmicë, Dushanovë, Sllapuzhan, Tërnje, Suharekë, Temeqinë dhe Bellanicë) sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Miratohen shpronësimet për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i rrugës N9 Fushë Kosovë-Arllat - Gjurgjicë (zonat kadastrale Arllat, Komoranë, Sllatinë e Madhe dhe Sllatinë e Vogël) sipas tabelave të bashkangjitura këtij Vendimi.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelën e përcaktuara në pikën 1. dhe 2. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në Aneksin 1. në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.

6. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është i detyruar të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/84
Datë: 19.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për negocimin dhe përgatitjen e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Republikën e Turqisë në këtë përbërje:

1.1. Blerim Ahmeti,	MTI	Kryesues;
1.2. Rexhep Bllaca,	MTI	anëtar;
1.3. Qerkin Berisha,	MF	anëtar;
1.4. Lulzim Rafuna,	Dogana	anëtar;
1.5. Valmira Rexhëbeqaj,	MF	anëtare;
1.6. Halit Hoxhaj,	MBPZHR	anëtar;
1.7. Suzana Krasniqi,	MPJ	anëtare;
1.8. Ruzhdi Halili,	ZKM	anëtar;
1.9. Arben Gegaj,	MD	anëtar.

2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Komisionin.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/84


Datë: 19.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011 si dhe duke u mbështetur në rekomandimin e Komitetit Drejtues të Projektit "Kosova e Re" nga takimi i datës 16 korrik 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Largohet termocentrali Kosova B nga pako tenderuese e aprovuar nga Komiteti Drejtues i Projektit "Kosova e Re" me datën 7 mars 2012.
2. Pakoja tenderuese "Kosova e Re" përbëhet nga këta komponentë:
 - 2.1. Ndërtimi i termocentralit të ri "Kosova e Re";
 - 2.2. Zhvillimi i mihjes në Sibovc për të ofruar linjit për termocentralet ekzistuese në Kosovë (termocentrali Kosova A dhe termocentrali Kosova B) dhe njësitë e reja të termocentralit "Kosova e Re", kur ato të hyjnë në shërbim.
3. Obligohet Komiteti Drejtues i Projektit "Kosova e Re" që të analizoj dhe të paraqesë opsionin më të mirë për përfshirjen e sektorit privat në termocentralin Kosova B, si pjesë e veçantë e transaksionit "Kosova e Re" me qëllim të përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.
4. Obligohet Komiteti Drejtues i Projektit "Kosova e Re" për zbatimin e këtij vendimi, si dhe të promovoj dhe të shqyrtoj mundësinë ligjore për rritjen e konkurrencës me qëllim të përmbylljes me sukses të procesit "Kosova e Re".

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/84

Datë: 19.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Procedurën Përmbartimore.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/84
Datë: 19.07.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2012, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Personelin e domosdoshëm për funksionalizimin e këtij Departamenti e cakton Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Fushëveprimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e Departamentit përcaktohen me akt të veçantë juridik.
4. Shfuqizohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.10/79 i datës 20.06.2012, për themelimin e Departamentit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar në kuadër të Ministrisë së Integrimit Evropian.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë